



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 263/15 prot.

Datë 04/04/2024

V E N D I M

Nr. 337/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04/04/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “MSE” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime – Prokurim me Mjete Elektronike, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (me një OE fitues për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-85000-10-24-2023, me objekt: “Mirëmbajtje e pajisjeve të mëdha mjekësore të prodhuesit Philips/ose ekuivalent, prodhuesit Siemens/ose ekuivalent, prodhuesit Toshiba/ose ekuivalent dhe prodhuesit GE Healthcare/ose ekuivalent” për 24 muaj” Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 210 434 997.08 (dyqind e dhjetë milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë tetë) Lekë pa TVSH, **Loti 3 me Nr. REF-85019-10-24-2023**, me objekt: “*Loti 3 - Mirembajtja Pajisje mjekësore prodhues Toshiba/ose ekuivalent*”, me fond limit për 24 muaj: 8 076 291.73 (tetë milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

- Ankimues:** Operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK me NIPT J61817047D dhe me adresë Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”, me adresë Rruga e Dibres Nr. 372, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “MSE” SHPK me NIPT L82001005A dhe me adresë, Rruga: “Diga e Liqenit”, nr. pasurie 8/312, vol. 25, fq. 40, zona kadastrale 8270, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.10.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime – Prokurim me Mjete Elektronike, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (me një OE fitues për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-85000-10-24-2023, me objekt: “*Mirëmbajtje e pajisjeve të mëdha mjekësore të prodhuesit Philips/ose ekuivalent, prodhuesit Siemens/ose ekuivalent, prodhuesit Toshiba/ose ekuivalent dhe prodhuesit GE Healthcare/ose ekuivalent’ për 24 muaj*” Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 210 434 997.08 (*dyqind e dhjetë milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë tetë*) Lekë pa TVSH, **Loti 3 me Nr. REF-85019-10-24-2023**, me objekt: “*Loti 3 - Mirembajtja Pajisje mjekësore prodhues Toshiba/ose ekuivalent*”, me fond limit për 24 muaj: 8 076 291.73 (tetë milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”.

II.2. Në datën 30.11.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se në datën 26.12.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “MSE” SHPK	6,999,600.00 lekë	kualifikuar
2. “BNT ELECTRONICS” SHPK,	7,189,770.00 lekë	kualifikuar

II.5. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton, se më 26.01.2024, është publikuar njoftimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 4 datë 29.01.2024.

II.6. Në datën 05.02.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3787, si dhe nr. protokollit 263/2024, datë 05.02.2024, i operatorit

ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MSE” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 263/2 prot., datë 06.02.2024 lidhur me arsyet e kualifikimit të operatorit ekonomik MSE” SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Më datë 13.02.2024, operatori ekonomik MSE” SHPK, ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumenteve nëpërmjet shërbimit postar, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 263/3 prot., datë 13.02.2024.

II.9. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të shkresës nr. 263/4 prot., datë 22.02.2024, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr. 441/7 prot., datë 29.02.2024, protokolluar me tonën nr. 263/5 prot., datë 01.03.2024, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe vendimin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues nga ku rezulton, se KSHA e autoritetit kontraktor **ka refuzuar** ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.11. Me shkresën protokolluar me tonën me nr. 263/6 prot., datë 06.03.2024, operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK, ka dërguar në KPP përmes shërbimit postar, informacion të plotë mbi aktin e trajtimit të ankesës së këtij të fundit nga ana e autoritetit kontraktor.

II.12. Me shkresën nr. 263/7 prot., datë 13.03.2024, KPP iu drejtuar autoritetit kontraktor QSUT, për të dërguar dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, të operatorit ekonomik “MSE” SHPK, në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”, i cili duhet **të jetë i njehsuar me vullë** të institucionit tuaj (lidhëse), i numerizuar me numrin e fletëve përkatëse.

II.13. Me shkresën nr. 263/8 prot., datë 19.03.2024, KPP ka vënë në dijeni autoritetin kontraktor dhe ankimuesin, se për shkaqe të arsyeshme, nuk mund të dalë me vendim brenda afatit të përcaktuar në ligj.

II.14. Me shkresën nr. 263/9 prot., datë 19.03.2024, KPP iu drejtua Qendrës Kombëtare të Biznesit me kërkesën për informacion, si më poshtë vijon:

[...] Komisioni i Prokurimit Publik, në ushtrim të funksioneve të tij, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve publike, i cili bën shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë, është duke shqyrtuar një ankesë me objekt “Loti 3 - Mirembajtja Pajisje mjekësore prodhues Toshiba/ose ekuivalent”. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj ankesë dhe në funksion të shqyrtimit sa më të drejtë dhe transparent të saj, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e informacionit nga ana juaj, si institucion kompetent, mbi detyrimin e kryerjes së regjistrimeve në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit.

Për sa më sipër parashtruar, në rastin konkret, konflikti administrativ ka të bëjë me një proces ku, personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së. Komisioni kërkon informacion nga ana juaj, nëse bizneset private shqiptare kanë detyrimin për të deklaruar (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tyre. Konkretisht, për sa më sipër kërkuar, kemi rastin në fjalë, për subjektin tregëtar “MSE” SHPK me NIPT L82001005A, i cili ka ortak “Cambridge Pathology B.V [..].

II.15. Me shkresën me nr. 441/10 prot., datë 28.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 263/10 prot., datë 02.04.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP përmes shërbimit postar, informacion e kërkuar.

II.16. Me shkresën nr. 263/11 prot., datë 02.04.2024, KPP iu drejtua Qendrës Kombëtare të Biznesit me rikërkesën për informacion, si më cituar.

II.17. Me shkresën nr. 2029/1 prot., datë 03.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 263/12 prot., datë 04.04.2024, Qendra Kombëtare e Biznesit ka dërguar informacionin e kërkuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “BNT ELECTRONICS” SHPK, për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MSE” SHPK me arsytet: “Së pari, OE MSE, nuk ka plotësuar sipas kërkesave ligjore Shtojcën 9 i Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit” perkatesisht Pjesa II: Shkaqet e perjashtimit ku ne paragrafin etrete kerkohet: Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese,,vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçarenga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Nisur nga verifikimi i bërë online dhe informacioni i marrë në ekstraktin e këtij OE nga QKB,rezulton se personat të cilët kanë kompetenca përfaqësuese,,vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik jane si më poshtë:

- Besa Vezelaj (Administratore)
- Can KutayOrten (Ortak)
- Arber Licaj (Ortak)
- Cambridge Pathology B.V (Ortak)

Kemi dyshimet dhe pretendimet tona se MSE nuk ka deklaruar emrat e të gjithë personave të cilët kanë kompetenca përfaqësues, vendimmarrëse, apo kontrolluese, që nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprat penale parashikuar në nenin 76/1 të LPP. Dyshojmë se ka deklaruar vetëm disa nga emrat e këtyre personave dhe veçanërisht përsa i përket të gjithë personave të cilët kanë kompetenca vendimmarrëse, kontrolluese apo përfaqësuese të ortakut “Cambridge pathology B.V”.

Sjellim në vëmendjen tuaj se person/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit mbikëqyrës, si aksionar ose si ortak që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda OE, është edhe Personi Juridik Cambridge Pathology B.V (Ortak).

Dyshojmë se shoqëria MSE nuk e ka deklaruar këtë person juridik nëse është i dënuar apo jo për veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP. Fillimisht duhej të deklaronin për personin juridik Cambridge Pathology B.V që nuk është i dënuar dhe në vijim duhej të deklaronin emrat e personave aksioner, ortak apo drejtor vendimmarrës të kësaj shoqërie, pra të Cambridge Pathology, në kushtet kur kjo shoqëri është si ortak në cilësinë e një personi juridik dhe si e tillë i linden këto detyrime që përmendëm më lart. Dyshojmë se ky Operator Ekonomik nuk ka deklaruar saktë për personin juridik Cambridge pathology si person me kompetenca vendimmarrëse, kontrolluese apo përfaqësuese si dhe nuk ka deklaruar emrat e personave me të njëjtat tagra brenda subjektit Cambridge Pathology. Edhe në rast se ka deklaruar emrin e vetëm një personi si përfaqësues të kësaj kompanie, sjellim në vëmendjen tuaj se kompania Cambridge Pathology B.V ka disa persona të cilët kanë kompetenca vendimmarrëse, kontrolluese apo përfaqësuese. Pra nuk është i mjaftueshëm deklarimi i vetëm një personi, duhej të deklaroheshin emrat e të gjithë personave me tagra vendimmarrëse, kontrolluese apo përfaqësuese të Cambridge pathology B.V.

Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me

vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij. Pretendojmë se në rastin e Operatorit Ekonomik MSE mungon informacioni për ortakun Cambridge pathology dhe personat e tjerë brenda kësaj kompanie të cilët kanë kompetenca vendimarrëse/kontrolluese apo përfaqësuese brenda këtij subjekti dhe nuk është bërë një deklaram i tillë për të gjithë personat. Pretendimet tona i bazojmë edhe referuar frymës së legjislacionit të prokurimit publik në përgjithësi dhe veçanarisht qëndrimin të mbajtur për të njëjtën çështje për mos plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit” të KPP nëpërmjet Vendimit Nr 135/2023, nr prot. 270/4 datë 23.02.2023, Ak duhet të vijojë me skualifikimin e këtij Operatori Ekonomik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, “të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Ofertuesi deklaron se:

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

-Formular përmbledhës i vetedeklarimit sipas shtojcës 9, të operatorit ekonomik “MSE” SHPK;

-Ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”;

-Vërtetim nr. 15 prot., datë 24.11.2023 nga Sektori i Gjendjes gjyqësore për “MSE” SHPK;

-Vërtetim i gjendjes gjyqësore për znj. B.V.;

-Vërtetim i gjendjes gjyqësore për z. A.L.;

-Vërtetim i gjendjes gjyqësore për z. C.O.;

-Vërtetim njësie me origjinalin me nr. Rep., 1098, datë 30.11.2023 i ekstraktit të shoqërisë “Cambridge Pathology B.V” dhe i përkthyer nga gjuha hollandeze në shqip, shoqëruar me vërttim përkthimi nr. Rep., 1400 datë 22.05.2023.

III.1.3. Në nenin 76, “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- dh) falsifikim;*
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.*

III.1.4. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.5. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që: *“Ofertuesi deklaron se: ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së”.*

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “MSE” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Nisur nga arsyeja e pretenduar e operatorit ekonomik ankimues për mospërmbushjen e kriterit për deklarimin e personit/ave që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit

Ekonomik, nuk është i/janë të dënuar ose nuk ka qenë i/të dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së, Komisioni e gjykoj të nevojshme, të bëjë verifikime drejtuar palëve të treta me shkresat nr. 263/9 prot., datë 19.03.2024 dhe nr. 263/11 prot., datë 02.04.2024, konkretisht Qendrës Kombëtare të Biznesit, si institucion kompetent, mbi detyrimin e kryerjes së regjistrimeve në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, për operatorin ekonomik “MSE” SHPK. Me shkresën nr. 2029/1 prot., datë 03.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 263/12 prot, datë 04.04.2024, Qendra Kombëtare e Biznesit ka dërguar informacionin e kërkuar, shoqëruar me dokumentacion provues ku sqaron se, ndër të tjera: [.....*Bashkëngjitur kësaj shkrese, gjeni një kopje të ekstraktit historik të regjistrit tregtar të shoqërisë “MSE” SHPK, me NIP/NUIS L82001005A, ku është i pasqyruar i gjithë historiku i veprimeve të subjektit në Regjistrin Tregtar, si edhe një kopje të ekstraktit historik të regjistrit të pronarëve përfitues, ku janë të pasqyruar pronarët përfitues të subjektit raportues të regjistruar në regjistrin tregtar....*].

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “MSE” SHPK për përmbushjen e kriterit më sipër, ka dorëzuar: *Formular përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, të operatorit ekonomik “MSE” SHPK; Ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”; Vërtetim nr. 15 prot., datë 24.11.2023 nga Sektori i Gjendjes gjyqësore për “MSE” SHPK; Vërtetim i gjendjes gjyqësore për znj. B.V.; Vërtetim i gjendjes gjyqësore për z. A.L.; Vërtetim i gjendjes gjyqësore për z. C.O.; Vërtetim njësisë me origjinalin me nr. Rep., 1098, datë 30.11.2023 i ekstraktit të shoqërisë “Cambridge Pathology B.V” dhe i përkthyer nga gjuha hollandeze në shqip, shoqëruar me vërtetim përkthimi nr. Rep., 1400 datë 22.05.2023.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “MSE” SHPK, mbi plotësimin e Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si dhe informacionit të dërguar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “MSE” SHPK nuk ka plotësuar me të gjithë të dhënat e duhura, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përmbushje të kriterit ku ofertuesi deklaroi personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së”.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues BNT ELECTRONICS qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “BNT ELECTRONICS” SHPK, për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MSE” SHPK me arsyet: *“Së dyti, MSE nuk ka plotësuar në mënyrë korrekte seksionin B: Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme. Kjo pasi, nisur nga eksperiencia jonë në procedura të shumta prokurimi si shoqëri me eksperiencë në këtë fushë, kemi dyshime dhe jemi të bindur se OE MSE ka vendosur vetëm emërtimin e kriterit të kërkuar në DST pra, në këtë formular thjesht ka cituar kriterin e përcaktuar nga AK dhe nuk janë dhënë të gjitha detajet sipas kriterit, pra dyshojmë se nuk është*

vendosur emri i plotë i punonjësit që kjo shoqëri do ta ketë në dispozicion dhe deklaron se përmbush këtë kriter si edhe as të dhënat e nevojshme mbi nr apo datën e certifikatës, nr apo detajet e diplomës, insitucionet/organet lëshuese etj. Sjellim në vëmendjen tuaj se referuar nenit 82 të LPP dhe nenit 26 te VKM 285 datë 19.05.2021, formulari i vetëdeklarimit plotësohet duke saktësuar dokumentin e kërkuar dhe burimin/faqen e internetit ku është marrë ky dokument.

Theksojmë se ky kriter teknik kualifikimi i vendosur lidhur me kërkesat për 2 Inxhinierë/Specialistë, kriter ky i pa përmbushur nga MSE, është tepër i rëndësishëm për realizimin me sukses të kësaj kontrate. Rezulton se në KVK, është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 2(dy)* Inxhinierë/Specialistë në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, certifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.

*Shënim: Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).

*Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomikë do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Gjithashtu referuar shtojcës 7, Formulari i Termave të referencës, ku kërkohen kushtet e Mirëmbajtjes parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore, Ak ka kërkuar: Shërbimi për ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet nga 2(dy) Inxhinierë/Specialistë të certifikuar dhe të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi.

Qëllimi i kësaj shtojce është që të gjitha seksionet e saj të plotësohen duke përcaktuar të gjitha elementet dhe të dhënat e duhura sipas kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, me qëllim që AK të mund të bëjë verifikimet përkatëse.

Mosplotësimi i kësaj shtojce në mënyrë të saktë vjen në kundërshtim jo vetëm me frymën e legjislacionit të prokurimit publik në përgjithësi, por gjithashtu vjen në kundërshtim edhe me praktikën që ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik që është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit si dhe merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme.

Pra sipas LPP duhen dhënë disa elementë identifikues mbi plotësimin e kriterit konkret, në rastin tonë për kriterin për punonjësit, pasi nuk është e plotë dhe e saktë vetëm citimi i kriterit siç është vendosur në DST, pasi referuar edhe nenit 92 të LPP, ku parashikohet se AK kur e sheh të arsyeshme u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave.

Në këtë kuptim AK kur e sheh të arsyeshme mund të bëjë verifikimet përkatëse dhe në rast se në formularin përmbledhës nuk është shënuar asnjë element dhe asnjë e dhënë identifikuese,

atëhere çfarë verifikimi do kryej AK, pra humbet koncepti i verifikimit.

Sipas formularit dhe LPP një operator ekonomik duhet të plotësojë kriterin duke shënuar emrin e punonjësit, emërtimin e profesionit, pozicionin/funksionin, kualifikimin, dëshmitë e kualifikimit, diplomat, certifikata trajnimi, organet që e kanë lëshuar etj me qëllim verifikimin e tyre në çdo nga ana AK.

Nga ana tjetër, deklarimi që në krye të herës në Formular, pra që në momentin e ofertimit, referuar frymës së LPP, synon barazinë, transparencë dhe mosdiskriminim në një procedurë prokurimi pasi duke mos deklaruar emrat e punonjësve që në momentin e ofertimit, lë vend për abuzim dhe nuk është transparente plotësimi i këtij kriteri vetëm me dorëzimin e dokumentacionit fizik më pas nëse shpallet fitues, pra dorëzohet dokumentacion kur nuk ke shënuar emrin në formularin përmbledhës se për cilin punonjës do të jetë ky dokument.

Deklarimi që në momentin e ofertimit të emrave të punonjësve që një operator ekonomik do të verë në dispozicion të AK për një procedurë të caktuar prokurimi, bëhet me qëllim që së pari të deklarohet se ka punonjës dhe së dyti të bëhet verifikimi nëse ky deklarim për këtë punonjës është i vërtetë dhe plotësohet kriteri me dokumentacionin sipas kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit shoqëruar me CV, kontratë individuale, diplomë, certifikatë trajnimi etj.

Pra nuk mund të bëhet ndryshimi i emrit të punonjësit në mes të procedurës së prokurimit, nëse nuk deklarohet që në fillim emri i tij në formular dhe për të njëjtin emër që përcaktohet dhe deklarohet në formular, në rast të shpalljes fitues paraqitet edhe dokumentacioni për të.

Për më tepër që në kriter është përcaktuar qartë dhe saktë se, vetëm ky staf i deklaruar do të kryejë ndërhyrjes e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.

AK ka përcaktuar se ky kriter do të quhet i përmbushur me dorëzimin e formularit përmbledhës sipas shtojcës 9, dhe me shpalljen fitues do të dorëzohet dokumentacioni përkatës.

Në rast se ky operator ekonomik nuk ka shënuar asnjë emër punonjësi në formular por thjesht ka cituar kriterin, atëhere së pari ky kriter nuk konsiderohet i plotësuar, dhe së dyti nuk është e mundur të bëhet verifikimi i tij pas sjelljes së dokumentacionit.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.b) të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- b) Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 2(dy)* *Inxhinierë/Specialistë* në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, certifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.**

**Shënim:* Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).

**Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i permbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.*

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “MSE” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetdeklarimit të operatorit ekonomik “MSE” SHPK;

III.2.3. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të

lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

c) *personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

ç) *operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

d) *operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

dh) *operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

e) *operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

ë) *operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

f) *operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

g) *operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

gj) *operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

j) *informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

k) *operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.5. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të

realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.


III.2.7. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka dorëzuar secili prej tyre Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të cilat në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor i pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

III.2.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “MSE” SHPK, ka deklaruar në *pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate”*, se disponon këto punonjës specialistë sipas profile respektive, konkretisht punonjësit:

- 2 (dy) punonjës profili inxhinierë;

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	Punonjës Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nëse, po, numri i punonjësve: 2 (dy) inxhinier
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	Profili i punonjësve Inxhinieri
	Makineri e mjete Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri: Besa VEZELAJ Firma <i>Besa Vezelaj</i> Vula  Data e dorëzimit të deklaratës 30/11/2023 NUIS: L82081053 - Albania	

Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [...] **Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, **plotësimi i kësaj deklaratë do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [...].****

Nisur nga pretendimet e ankimuesit dhe korrespondencës së kryer me Agjencinë e Prokurimit Publik, të dhënave të deklaruara në pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate”, gjykojmë, se punonjësit e deklaruar të operatorit ekonomik “MSE” SHPK, kanë të evidentuar të dhënat si numrin e punonjësit dhe profilin respektiv të kërkuar sipas pikës 2.3.b) të kriteve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriteve të kualifikimit, për këtë fazë, të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriteve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”,

“d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “MSE” SHPK, me deklarinimin e punonjësve të profilit sipas kërkesave të pikës 2.3.b), (në numër dhe profil, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në këtë procedurë prokurimi), në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kritereve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.b) të kapacitetit teknik.

Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MSE” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “BNT ELECTRONICS” SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “BNT ELECTRONICS” SHPK, për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MSE” SHPK me arsyet: *“Së treti: Ne jemi të bindur katërcipërisht se MSE nuk ka në stafin e tij Inxhinierë/Specialistë të trajnuar dhe as të certifikuar nga Canon Medical i cili është prodhues i pajisjes objekt prokurimi. Prodhuesi Canon, ofron trajnime dhe certifikime vetëm për distributorët e tyre dhe MSE nuk ka qenë asnjëherë distributor i Canon Medical apo i Toshiba (emri tregëtar i mëparshëm i prodhuesit të pajisjes objekt prokurimi) në vitet e mëparshme në të cilat CANON ka organizuar Trajnime. Inxhinierë dhe Specialistë të certifikuar për pajisjet objekt prokurimi, theksojmë se pajisja objekt prokurimi është Scanner i prodhuesit Canon dhe për këtë pajisje objekt prokurimi në gjithë territorin Shqipërisë, vetëm shoqëria jonë BNT Electronics shpk ka Inxhinierë të certifikuar si nga Canon ashtu edhe nga Toshiba e cila ishte paraardhëse e Canon medical. Pra MSE nuk plotëson kriterin e inxhinierëve të certifikuar nga prodhuesi.*

Për më tepër, ne konstatuam në SPE se ky operator ka marrë pjesë edhe në Lotet e tjera për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore siç është Loti_1 - Mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent si dhe Lotin Loti 2 - Mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Siemens /ose ekuivalent .

Siç vërehet, pajisjet objekt prokurimi në këto lote janë të prodhuesit Philips dhe Siemens, dhe sigurisht që edhe në këto lote ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit se plotëson të gjitha kriteret e kualifikimi, specifikimet teknike si dhe ka staf të certifikuar por ne jemi të bindur se MSE ashtu siç nuk ka staf të certifikuar nga Canon medical apo Toshiba po ashtu nuk ka staf të certifikuar as nga Siemens dhe Philips pasi këto 2 prodhues (Siemens dhe Philips) kanë trajnuar dhe certifikuar distributorët e tyre që janë në Shqipëri dhe që kanë marrë pjesë në këto Lote. Jemi të bindur për këtë informacion pasi kemi 30 vite në treg dhe e dimë shumë mirë se si funksionon marrëdhënia prodhues dhe distributor apo përfaqësues territorial. Normalisht kur një kompani është distributor apo përfaqësues në Shqipëri e një prodhuesi të caktuar, për shkak të politikave tregëtare nuk lejohet që ky prodhues të trajnojë apo të certifikojë

staf të një konkurenti të distributorit apo përfaqesuesit të tij.

Pra, MSE ka bërë deklaramë të rreme në këto Lote dhe për këto arsye AK duhet ta referojë këtë çështje në App dhe të kërkojë përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike të këtij Operatori Ekonomik.

Ne gjykojmë se ky operator ekonomik ka keqinformuar dhe ka bërë deklaramë të rreme në lidhje me këtë kriter pas, nuk ka përcaktuar emrin e punonjësve me të gjitha të dhënat siç kërkohet nga AK në DST, ndërkohë ka dorëzuar dokumentacion fizik pas shpalljes fitues për punonjës të cilët as nuk i ka deklaruar.

Gjithashtu, dokumentacioni që ka paraqitur ky operator ekonomik përmban të dhëna të rreme për arsyet që thamë më lart, pasi ky operator ekonomik nuk ka në stafin e tij punonjës të certifikuar nga prodhuesit për këta punonjës.

Në nenin 23/ë të LPP është përcaktuar se: “Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione:

ë) përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të përfutuar kontrata publike, në përputhje me parashikimet në këtë ligj”.

Ne nenin 78/1/a të LPP parashikohet se:

1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontratat publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për:

a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi;

Në nenin 110 të VKM 285/2021 përcaktohet:

1. APP-ja përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 (tre) muaj deri në 3 (tre) vjet, në rastet e përcaktuara në nenin 78, të LPP-s?

2. Procedimi administrativ ndaj një operatori ekonomik mund të iniciohet në bazë të kërkesave nga të tretët, të argumentuara dhe mbështetura në prova dokumentare ose gjatë verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave apo monitorimit të kontratave, nga vetë APP-së.....

Sa më sipër ne kërkojmë që AK dhe KPP të bëjnë verifikimet përkatëse dhe të kërkojnë përjashtimin nga e drejta për të fituar kontrata publike të operatorit ekonomik MSE për keqinformim dhe deklaramë të rreme sipas parashikimeve ligjore në fuqi, duke ia paraqitur rastin APP për të filluar hetimin administrativ sipas funksioneve të saj ligjore”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.b) të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- b) Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën **2(dy)* Inxhinierë/Specialistë** në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, certifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.

**Shënim: Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).*

**Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i permbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit permbledhes të vetdeklarimit sipas shtojces 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.*

Shtojca 7

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS (TË NJEJTA PËR TË GJITHA LOTET)

SPECIFIKIMET TEKNIKE/TERMAT E REFERENCËS:

Nevojat për organizimin funksional/strukturor të operatorit kontraktues dhe të ofrimit të shërbimit për mirëmbajtjen e plotë "Full Risk" të pajisjeve janë të grupuara në disa kategori, dhe janë të njëjta për çdo grupim në Lote.

Mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore

- 1. Mirëmbajtja parandaluese apo preventive të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet në përputhje me rekomandimet e prodhuesit përkatës për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e tyre dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetërimi apo përkeqësimi i performancës.*
- 2. Shërbimi për ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet nga 2(dy) Inxhinierë/Specialistë të certifikuar dhe të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi.*
- 3. Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes/ve dhe një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin, procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë, përfshirë kalibrimet.*

III.3.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik "MSE" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin permbledhës të vetdeklarimit të operatorit ekonomik "MSE" SHPK;

-Certifikatë nga prodhuesi Canon Medical Systems Europe B.V. për Z. F.XH, CTT1224:CT Foundation (përkthyer, dhe noterizuar)

-Certifikatë nga prodhuesi Canon Medical Systems Europe B.V. për Z. E.H. CTT1224:CT Foundation (përkthyer, dhe noterizuar)

III.3.3. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.b) “Kapaciteti teknik” të dokumenteve standarde të tenderit të modifikuara për disponimin e **2(dy)* Inxhinierë/Specialistë** në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, çertifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore, dhe operatori ekonomik “MSE” SHPK ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), 1- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 9), 2- Dokumentacion për stafin teknik ndër të tjera edhe:

-Certifikatë nga prodhuesi Canon Medical Systems Europe B.V. për Z. F.XH, CTT1224:CT Foundation (përkthyer, dhe noterizuar)

-Certifikatë nga prodhuesi Canon Medical Systems Europe B.V. për Z. E.H. CTT1224:CT Foundation (përkthyer, dhe noterizuar)

Autoriteti kontraktor ka kualifikuar këtë operator ekonomik në përmbushje të kërkesave të

dokumenteve standarde të tenderit, për momentin procedural të fazës së ofertimit, pasi referuar shtojcës 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa III kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, Pika B-Deklaratë ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevosjhme (nëse kërkohet): “Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj se nën përgjegjësinë time të plotë se: Un kam punonjësit e nevosjhëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç kërkohet në dokumentat e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor”. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë këto dokumente, e para, në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “MSE” SHPK në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës, konkretisht ka deklaruar stafin e kualifikuar në shtojcën përkatëse, ka ngarkuar në SPE dhe deklaratën sipas përcaktimit të pikës 2.3.b) të dokumenteve standarde të tenderit në lidhje me përmbushjen e kriterit mbi disponimin e 2 (dy) inxhinierëve/specialistëve të kërkuar për realizimin me sukses të procedurës objekt-shqyrtimi.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka theksuar, se për përmbushjen e kriterit në fazën e vlerësimit, ofertuesit do të duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Ne rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit.

Me shkresën nr. 263/7 prot., datë 13.03.2024, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor QSUT, për të dërguar dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, të operatorit ekonomik “MSE” SHPK, në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”, i cili duhet të jetë i njehsuar me vulë të institucionit tuaj (lidhëse), i numerizuar me numrin e fletëve përkatëse. Me shkresën me nr. 441/10 prot., datë 28.03.2024, protokolluar me tonën me nr.

263/10 prot., datë 02.04.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP përmes shërbimit postar, informacion e kërkuar.

Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “MSE” SHPK, pranë autoritetit kontraktor, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, me qëllim vërtetimin e deklarimeve të tij në formularin përmbledhës së vetëdeklarimit, për sa i përket disponimit të 2 (dy) inxhinierëve/specialistëve të kërkuar për realizimin me sukses të procedurës objekt-shqyrtimi.

Operatori ekonomik ka provuar me dokumentacion mbështetës të kërkuar në DST, në lidhje me disponimin e 2(dy)* Inxhinierë/Specialistë në stafin e vet, të trajnuar për pajisjet mjekësore, të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet:

-diplomës, për secilin inxhinier, Z. E.H dhe Z. F.Xh.

-certifikatës së trajnimit, për secilin inxhinier, Z. E.H dhe Z. F.Xh, nga prodhuesi Canon Medical Systems Europe B.V.

-CV-së, për secilin inxhinier, Z. E.H dhe Z. F.Xh.

-kontratës individuale të punës, për secilin inxhinier, Z. E.H dhe Z. F.Xh.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MSE” SHPK në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. KPP gjykon, se kualifikimi për operatorin ekonomik në rastin konkret, është në përputhje me kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kapaciteti. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se kualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor është i drejtë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK mbi deklarime të rreme në përmbushje të këtij kriteri, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës, referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuarit), në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: *“në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës*

për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Pra, operatori ekonomik ankimes duhet të argumentojë/dëshmojë, se përmbushja e kriterëve të DT të hartuara nga autoriteti kontraktor, në lidhje me këto deklarime, është në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik, dhe nuk është thjesht një pretendim se nuk plotësohen nga një operator ekonomik ofertues.

Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MSE” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “BNT ELECTRONICS” SHPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “BNT ELECTRONICS” SHPK, për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MSE” SHPK me arsyet: *“Së katërti_ Theksojmë fort faktin se edhe në rast se ky Operator Ekonomik, ka paraqitur ndonjë Autorizim Prodhuesi për Lotin 3, “Mirëmbajtje pajisje mjekësore Toshiba ose ekuivalent” ose ka paraqitur Autorizim prodhuesi në lotet e tjera, ky fakt nuk përbën aspak garanci për të garantuar staf të certifikuar apo trajnuar pasi referuar Kriterëve të përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit si dhe referuar të gjithë Dokumentave Standarte të Tenderit për këtë procedurë, rezulton se AK nuk ka kërkuar paraqitjen dhe as deklarin e një Autorizimi nga Prodhuesi apo nga distributor i autorizuar prandaj AK nuk duhet ta konsiderojë në vlerësimin e ofertës asnjë dokument të pa kërkuar në DST por paraqitur nga ky operator. Sjellim në vëmendjen tuaj se referuar VKM 285 datë 19.05.2020 neni 82 : Shqyrtimi dhe Vlerësimi i Ofertave, pika 2 parashikon: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe janë të përgjithshme/vlefshme. Pra ligjvënësi ka theksuar se KVO duhet ti referohet vetëm kërkesave për kualifikim të përcaktuara në DST dhe në këtë rast paraqitja e një Autorizim prodhuesi apo nga distributor i autorizuar nuk është një dokument për kualifikim i përcaktuar në DST dhe si rrjedhojë KVO nuk duhet të konsiderojë dokumentin Autorizim Prodhuesi.*

Autorizimi i prodhuesit, së pari është një dokument që nuk është kërkuar nga AK, së dyti lidhur me kriterin për punonjësit AK ka kërkuar plotësimin e kriterit me dorëzimin e disa dokumentave si CV, certifikatë trajnimi etj, të cilat nuk plotësohen kurrsesi me këtë dokument të pakërkuar në DST nga AK.

Pra OE MSE nuk plotëson kapacitetin teknik për sa i përket kërkesave për inxhinierë të trajnuar dhe certifikuar për pajisjet objekt prokurimi pasi ky operator nuk ka staf të certifikuar nga Canon Medical dhe as nga Toshiba.

Pra MSE nuk e plotëson këtë kriter, nuk ka staf të certifikuar dhe trajnuar nga Canon dhe nëse ka paraqitur ndonjë dokument të tillë dyshojmë për keqinformim dhe paraqitje dokumentacioni me të dhëna të rreme për arsyet që thamë më lart”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1 Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar asnjë autorizim prodhuesi. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “MSE” SHPK, Komisioni vëren se, ky i fundit nuk ka dorëzuar asnjë dokument me emërtim “autorizim prodhuese”, siç mund të pretendohet nga ana e operatorit ekonomik ankimues “BNT ELECTRONICS” SHPK. Ndërsa, në lidhje me pretendimin mbi paraqitjen e ndonjë dokumenti me të dhëna të rreme mbi certifikimin e stafit teknik të kërkuar, Komisioni shqyrtoi dokumentacionin e noterizuar/original të dorëzuar në AK nga ana e operatorit ekonomik “MSE” SHPK. Dokumentacioni i dorëzuar mbi plotësimin e këtij kriteri është:

-diplomës, për secilin inxhinier, Z. E.H dhe Z. F.Xh.

-certifikatës së trajnimit, për secilin inxhinier, Z. E.H dhe Z. F.Xh, nga prodhuesi Canon Medical Systems Europe B.V.

-CV-së, për secilin inxhinier, Z. E.H dhe Z. F.Xh.

-kontratës individuale të punës, për secilin inxhinier, Z. E.H dhe Z. F.Xh.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MSE” SHPK në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK mbi deklarime të rreme në përmbushje të këtij kriteri, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuarit), si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: *“në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*, operatori ekonomik ankimues duhet të argumentojë/dëshmojë, se përmbushja e kriterëve të DT të hartuara nga autoriteti kontraktor, në lidhje me këto deklarime, është në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik, dhe nuk është thjesht një pretendim se nuk plotësohen nga një operator ekonomik ofertues.

Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MSE” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “BNT ELECTRONICS” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “BNT ELECTRONICS” SHPK, për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MSE” SHPK me arsyet: *“dyshojmë se shoqëria MSE nuk plotëson kushtin e furnizimeve të ngjashme të kërkuara. Duke qenë se*

shoqëria jonë ka një histori 30 vjeçare në këtë treg pune, njohim në detaje kapacitetet e operatorëve të tjerë pjesëmarrës në të njëjtat procedura prokurimi që ne marrim pjesë. Dhe konkludojmë se shoqëria MSE e vetme nuk plotëson kriteret e kualifikimit për këtë procedurë. Nuk plotëson kapacitetin teknik përsa i përket furnizimeve të ngjashme që duhet të ketë realizuar për 3 vitet e fundit nga publikimi i kësaj procedure, kjo pasi MSE ka marrë pjesë në të gjitha lotet e kësaj procedure të zhvilluar nga QSUT për mirëmbajtje. Referuar kërkesave teknike në KVK të kësaj procedurë, përkatësisht pika 2.3 kapaciteti teknik ku kërkon: Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

-Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen vërtetime* të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilin ofertohej, konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" në pikën 2.10 / 2.14.

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, 20% do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet

Rezulton se MSE ka marrë pjesë në:

Loti 1 - Mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent, me fond 88 858 534.38 ku vlera e furnizimeve të ngjashme të realizuara kërkohet në vlerën: 17,771,707.

Loti 2 - Mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Siemens /ose ekuivalent, vlera e furnizimeve të ngjashme të kërkuara: 17,719,974.

Loti 3 - Mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Toshiba/ose ekuivalent me fond limit: 8 076 291.73, vlera e furnizimeve të ngjashme të kërkuara : 1,615,258.

Siç edhe përmendet më lartë, vlera e furnizimeve të ngjashme të paraqitura në tender aplikohet përtë gjitha lotet sëbashku ku OE merr pjesë. Pra jemi të bindur se MSE nuk ka realizuar me sukses furnizime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën totale prej 37,106,939 lekë në total (të aplikuar për të gjitha lotet ku ka marrë pjesë) brenda 3 viteve të fundit dhe nuk ka paraqitur prova të vlefshme për të provuar këtë kapacitet teknik. Jemi plotësisht të bindur për këtë fakt pasi kemi 30 vite eksperiencë në tregun e prokurimeve mjekësore dhe njohim kapacitetet e secilit konkurent. Për më tepër, referuar Bilanceve të deklaruara në ekstraktin e këtij operatori ku nuk rezulton të jetë e deklaruar një xhiro e lartë. Për më tepër, për të saktësuar dhe provuar bindjet tona, kemi kontrolluar të gjithë buletinet e publikuar në SPE dhe rezulton se ky OE nuk ka fituar procedura prokurimi në fushën e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore jo vetëm në QSUT po as në institucione të tjera të fushës së shëndetësisë. Për më tepër, referuar ekstraktit të këtij subjekti, bilanceve të paraqitura në këtë ekstrakt, rezulton se ky subjekt nuk ka deklaruar një vlerë të konsiderueshme xhiro dhe për

rrjedhojë jemi të bindur se ky OE nuk ka furnizime të ngjashme në vlerën e kërkuar, pra nuk plotëson kapacitetin teknik të kërkuar.

Gjithashtu, edhe në rast se ka paraqitur kontrata të ngjashme me sektorin privat, kërkojmë verifikimin e tyre për shumën e deklaruar, si edhe për vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Referuar procedurës së prokurimit objekt - ankimi, KPP konstaton, se kjo procedurë prokurimi është e ndarë në lotë dhe vetë operatori ekonomik ankimues parashtron pretendime në lidhje me përmbushjen e kriterëve të kualifikimit nga operatori ekonomik “MSE” ShPK, referuar loteve ku ky i fundit ka marrë pjesë.

III.5.1.1. Neni 42 i Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht, *Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.*

III.5.1.2. KPP vëren, se ankimuesi në parashtrimet në ankesë kundërshton kualifikimin e operatorit ekonomik “MSE” SHPK me argumentet se nuk plotëson vlerën e furnizimeve të ngjashme me objektin e prokurimit për të gjitha lotet. Ndërkohë KPP vëren, se ankesa e operatorit ekonomik ankimues i referohet vetëm lotit 3 me objekt: **Loti 3 me Nr. REF-85019-10-24-2023**, me objekt: *“Loti 3 - Mirembajtja Pajisje mjekësore prodhues Toshiba/ose ekuivalent”, dhe rredhimisht ankimuesi ka paguar tarifën e ankesës vetëm për lotin 3. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se neni 110 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë në KPP, në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje KPP.*

Procedura përpara KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura (*lat.-jurisdicion voluntari*), pasi KPP nuk mund të bëhet vetiniciatore e fillimit të procedurave (*ex officio*). Si rregull, investimi i KPP është i bazuar (*faktikisht i kufizuar*) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara. KPP sqaron, se interesi në gjykim përcakton edhe pozitën procedurale të palëve në proces. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se e drejta ligjore e subjektit për parashtrimin e një pretendimi para Komisionit të Prokurimit Publik për mbrojtjen e një interesi të caktuar që njihet si legjitimitimi, së bashku me çështjen e kompetencës lëndore të ogranit administrativ njihet që specifikohen ndryshe edhe si “objekti i ankesës” (pika 2 gërma “b” e Vendimit nr. 766/2021, datë 13.10.2021 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik), si edhe kushti i shterimit të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (neni 110 pika 2 e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar), janë kriteret përcaktuese për të filluar edhe një shqyrtim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP konstaton, se operatori

ekonomik ankimues ka parashtruar pretendime në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MSE” SHPK, duke e lidhur këtë të fundit me ligjshmërinë e veprimeve (*kualifikimin/skualifikimin*) nga lote të tjera të procedurës së prokurimit, për të cilat, operatori ekonomik ankimues nuk ka shteruar rrugën e ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në respekt të nenit 110, pika 2 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.202 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Kështu, KPP konstaton, se operatori ekonomik me anë të ankesës së tij për lotin e procedurës së prokurimit objekt – ankimi, ka kërkuar kryerjen e rishikimit administrativ referuar loteve të tjera të procedurës së prokurimit për të cilat nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet formale të paraqitjes së ankesës. Në nenin 42 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës” . Në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar qartësisht se fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër duke e paraparë si procedurë të veçantë brenda një procedure. Në rastin konkret, që ankimuesi të gëzojë legjitimitet aktiv, si edhe legjitimitet të vërë në lëvizje Komisionin e Prokurimit Publik (*lat- locus standi*), të shqyrtojë dhe vlerësojë dokumentacionin e paraqitur nga operatorë të tjerë ekonomikë në lote të tjera të procedurës së prokurimit, do të duhej që ankimuesi të kishte ezauruar ankim administrativ edhe për lotet në të cilat ngre pretendime. Në të kundërt, Komisioni i Prokurimit Publik nuk gëzon kompetenca lëndore të shqyrtimit të ligjshmërisë së veprimeve (*kualifikimit/skualifikimit*) të operatorëve të tjerë ekonomikë, megjithëse ankesa është e lidhur me lotin konkret, në lote për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit, e për rrjedhojë KPP nuk ka ushtruar të drejtën e tij ligjore të shprehet, si me vendime të ndërmjetme për pezullimin e procedurës dhe/ose kërkimin e informacionit, si edhe me vendim përfundimtar mbi themelin e çështjes. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të sqarojë, se ky i fundit është paraparë nga ligjvënësi si një organ “*sui generis*”, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, quasi gjykatë, e pranuar edhe nga Gjykata Kushtetuese. Në rastin konkret, ankesa në KPP dhe rishikimi administrativ i procedurës së prokurimit kushtëzohet nga dy komponentë bazë, ai i ndjekjes së rrugës së ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe i kryerjes së veprimeve procedurale (*pagimit të tarifës*), si shkak për nisjen e shqyrtimit administrativ. Sa më sipër, KPP gjykon, se kjo e fundit nuk mund të shqyrtojë dhe vlerësojë mbi dokumentacione të dorëzuara në lote të tjera të procedurës së prokurimit në kushtet kur për faj të ankimuesit ky i fundit nuk ka ezauruar ankimin administrativ në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për lotet e mësipërme.

Sa më sipër KPP gjykon, se nuk mund të marrë në shqyrtim pretendimet e sipërcituara të ankimuesit për pretendime që lidhen me përmbushjen e kushteve kumulative për të gjitha lotet, por do të gjykojë të gjitha pretendimet e ngritura nga ankimuesi, që kanë lidhje me lotin objekt ankimi si më poshtë vijon.

III.5.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.a) të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen vërtetime* të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilin ofertohej, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në pikën 2.10 / 2.14.

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, 20% do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

III.5.2.1. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “MSE” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

-Dokumenti _9_ Fatura për shërbime të ngjashme-1;

- Fatura Elektronike (nr.154/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës **International Hospital Sh.a.**
- Fatura Elektronike (nr.155/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës **International Hospital Sh.a.**
- Fatura Elektronike (nr.156/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës **American Hospital Sh.a.F.**
- Fatura Elektronike (nr.157/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës **American Hospital Sh.a.Drr.**
- Fatura Elektronike (nr.158/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës **American Hospital Sh.a.GJ.**
- Fatura Elektronike (nr.159/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës **American Hospital Sh.a.Sh.**
- Fatura Elektronike (nr.160/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës **Spitali Continental.**

- *Fatura Elektronike (nr.161/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.Kamëz.*

-Dokumenti _10_ Fatura për shërbime të ngjashme-2;

- *Fatura Tatimore Shitje (nr.144/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.*
- *Fatura Taimore Shitje (nr.145/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.146/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.2.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.147/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.3.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.148/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës International Hospital Sh.a.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.149/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës International Hospital Sh.a.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.150/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.F.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.833/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.GJ.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.837/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.Kamëz.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.835/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës Spitali European.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.834/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.Sh.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.836/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës Klinika Kristi.*
- *Fatura Tatimore Shitje (nr.822/2021, datë 30.06.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.Drr.*

-Dokumenti _11_ Fatura për shërbime të ngjashme-3;

- *Fatura Elektronike (nr.152/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.*
- *Fatura Elektronike (nr.153/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.3.*
- *Fatura Elektronike (nr.154/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës International Hospital Sh.a.*
- *Fatura Elektronike (nr.155/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës International Hospital Sh.a.*

- *Fatura Elektronike (nr.156/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.F.*
- *Fatura Elektronike (nr.157/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.Drr.*
- *Fatura Elektronike (nr.158/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.GJ.*
- *Fatura Elektronike (nr.159/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.Sh.*
- *Fatura Elektronike (nr.160/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës Spitali Continental.*
- *Fatura Elektronike (nr.161/2021, datë 30.09.2021;), me shitës “MSE” SHPK dhe blerës American Hospital Sh.a.Kamëz.*

III.5.2.2. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.5.2.3. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të*

lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga **një ent publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

III.5.2.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.5.2.5 Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për shërbime, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 41, pika 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që

prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla, duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) Kontrata e shërbimit duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe njëre prej këtyre elementeve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Për përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “MSE” SHPK ka paraqitur si dëshmi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) Fatura Tatimore për vitin 2021, ku vërteton se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me disa subjekte private (shiko pikën III.5.2. të këtij vendimi).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, për lotin 3, nga operatori ekonomik “MSE” SHPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur fatura tatimore në të cilat vërteton se ndër të tjera ka kryer shërbime gjatë tre viteve të fundit me shërbimin objekt - prokurimi (shërbim mirëmbajtje). Komisioni vëren, se nga përlllogaritja financiare e të gjitha faturave të paraqitura për vitin 2021, nga operatori ekonomik “MSE” SHPK, janë në vlerën 3,328,882.103.31 lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pra në vlerën 1,615,258.35 lekë pa Tvsh.

Në lidhje me elementin natyrë e ngjashme mbi shërbimet e kryera, Komisioni konstatoi, se përshkrimi i shërbimit në faturat elektronike të paraqitura të vitit 2021, është Shërbim mirëmbajtje aparaturash full risk/skaner. Sa më sipër, për sa kohë operatori ekonomik “MSE” SHPK, përmbush kriterin në lidhje me shërbime të mëparshme të ngjashme, në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit në një vlerë jo më të vogël sa 20% e vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot), faturat janë brenda afatit gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (elementi kohë) si dhe janë

të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme), rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur.

Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim ryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit sa i takon eksperiencës së ngjashme, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sqarojmë, se bazuar në nenin 82, pika 1, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka arritur ta vërtetojë atë. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se operatori ekonomikë “MSE” SHPK, përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me shërbime të mëparshme të ngjashme, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “MSE” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.a) të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “BNT ELECTRONICS” SHPK nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “BNT ELECTRONICS” SHPK, për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MSE” SHPK me arsyet: *“kemi dyshime se Sigurimi i ofertës së paraqitur për këtë procedurë prokurimi nuk është paraqitur sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, kjo për arsye si më poshtë:*

Në seksionin 3 të DST, AK ka kërkuar për këtë Lot sigurimin e ofertës si më poshtë: Vlera e kërkuar për sigurimin:

Loti 3 - Mirëmbajtja Pajisje mjekësore prodhues Toshiba/ose ekuivalent 161 525,8346 lekë

Dyshojmë se vlera e siguruar nga MSE për këtë lot nuk është e saktë dhe e plotë sipas kërkesave të AK, pasi nuk ka përfshirë të plotë vlerën që gjendet pas presjes dhjetore.

Për të gjitha arsyet si më lartë, konkludojmë se OE MSE nuk plotëson kriteret kualifikuese në këtë procedure prokurimi dhe për këtë arsye AK duhet të vijojë me skualifikimin e tij.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, gjykojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Sqarojmë se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e prokurimit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Si përfundim, referuar LPP neni 92 "Shqyrtimi i Ofertave" pika 3, ku parashikon: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Mospërcaktimi i sakte i vlerës se sigurimit të ofertes, nuk mbulon ofertën e paraqitur nga ky operator ekonomik.

Gjithashtu dyshojmë se nuk është paraqitur një formular i sigurimit të ofertes sipas kërkesave të AK që përmban të gjitha elementet e duhur, të gjitha pikat, si edhe afatin e vlefshmerisë të përcaktuar në DST, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në shtojcën 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" pika 2.1.b të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

III.6.2. Në shtojcën 3 “Formulari i Sigurimit të Ofertës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 3.

[Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik]

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

III.6.3. Në Seksionin 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike”, pika 3.1 “Sigurimi i ofertës”, “Njoftimi i kontratës”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-

ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mënyrën e paraqitjes, afatin dhe vlerën e sigurimit të ofertës, si më poshtë:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: *(e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël.*

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **4 208 699,942 (kater milion e dyqind e tete mije e gjashtëqind e nentëdhjetë e nente presje nentëqind e dyzet e dy) lekë.**

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës (në total për të gjitha lotet) e konvertuar në euro, sipas kursit zyrtar të Bankes së Shqipërisë, datë (bazuar në kursin 105.71 euro, datë: 24.10.2023 është: 39 813,64054 Euro.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Nr. Loti	Emërtim loti	Sigurimi i ofertës për secilin lot
1	Loti 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent	1 777 170,688
2	Loti 2 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Siemens /ose ekuivalent	1 771 997,419
3	Loti 3 - Mirembajtja Pajisje mjekësore prodhues Toshiba/ose ekuivalent	161 525,8346
4	Loti 4 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Ge Healthcare /ose ekuivalent	498 006

Nr. Loti	Emërtim loti	Sigurimi i ofertës në euro
1	Loti 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent	16 811,75563
2	Loti 2 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Siemens /ose ekuivalent	16 762,81732
3	Loti 3 - Mirembajtja Pajisje mjekësore prodhues Toshiba/ose ekuivalent	1 528,00903
4	Loti 4 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Ge Healthcare /ose ekuivalent	4 711,058556

3.1.2 Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor :

- **Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë**
- **Kodi i Institucionit përfitues 1013049**

- Kodi i Degës së Thesarit ku vepron **3535**
- Kodi i Llog. Ekonomike **7115600**

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

- garancisë bankare **X**
ose
- nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 180 (njqind e tetëdhjetë) ditë

III.6.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “MSE” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

-Formularin e Sigurimit të Ofertës me Nr.BND00202088, në emër të shoqërisë “MSE” SHPK, të lëshuar më datë 23.11.2023, nga shoqëria e sigurimeve “INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP” SHA për Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si kusht për sigurimin e ofertës së operatorit ekonomik “MSE” SHPK për procedurën e prokurimit publik me objekt: “Loti 3 - Mirembajtja Pajisje mjekësore prodhues Toshiba/ose ekuivalent”, me vlerën 161,525.90 lekë, për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës që është 180 ditë.

III.6.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- gjendjen ekonomike dhe financiare;
- aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.6.6. Në neni 83, pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

III.6.7. Në nenin 30 pika 3 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “3. *Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.*”

III.6.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet, se në kriterin kualifikues të pikës 2.1.b të Shtojcës 8/2 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, ka përcaktuar që ofertuesit të dorëzojnë në momentin e ofertimit, sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3 të këtyre dokumenteve, si dhe sipas përcaktimeve në pikat 3.1.3, 3.1.2 dhe 3.1.3 të Seksioni 3: “*Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike*”, të Njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka përcaktuar format alternative të paraqitjes së sigurimit të ofertës, ku njëra është në formën e garancisë bankare ose tjetra nga një shoqëri e licencuar nga autoritetet kompetente, sikurse parashikohet dhe në nenin 83 të LPP-së, gjithashtu ka parashikuar edhe vlerën e sigurimit prej 161,525.8346 lekë, si dhe afatin e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës për një periudhë prej 180 ditë.

III.6.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, nga operatori ekonomik “MSE” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Konkretisht, referuar “Formularit të Sigurimit të Ofertës” të dorëzuar nga operatori ekonomik “MSE” SHPK, konstatohet, se ky i fundit është lëshuar në njërin prej formave të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur dhe konkretisht nga shoqëri të licencuara nga autoritetet kompetente dhe përkatësisht shoqëria e sigurimit “**INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP**” SHA, ku formulari i sigurimit të ofertës së lëshuar nga kjo shoqëri dhe përkatësisht formulari me Nr. *BND00202088*, është sipas Shtojcës 3 të dokumenteve të tenderit të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor, si dhe ky formular është sipas vlerës dhe

afatit të vlefshmërisë së kërkuar nga autoriteti kontraktor në pikat 3.1.3, 3.1.2 dhe 3.1.3 të Seksioni 3: “*Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike*” të dokumenteve të tenderit. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se formulari i sigurimit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MSE” SHPK, është lëshuar nga shoqëria e sigurimeve “*INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP*” SHA më datë 23.11.2023, ku është përcaktuar se ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës që është 180 ditë, si dhe në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “MSE” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.b, të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*BNT ELECTRONICS*” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime – Prokurim me Mjete Elektronike, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (me një OE fitues për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*” me objekt “**Loti 3 me Nr. REF-85019-10-24-2023**, me objekt: “*Loti 3 - Mirembajtja Pajisje mjekësore prodhues Toshiba/ose ekuivalent*”, me fond limit për 24 muaj: 8 076 291.73 (tetë milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “*Nënë Tereza*”.
2. Autoriteti kontraktor të skualifikojë operatorin ekonomik “*MSE*” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*BNT ELECTRONICS*” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**

**Anëtar
Kreshnik Ternova**

**Anëtar
Anila Malaj**

**Kryetar
Jonaid Myzyri**

